

Ec dhe Fol

Përdori këto karta
për të të ndihmuar të
flasësh me bebin ose
fëmijën tënd ndërkohë
që je jashtë. Kjo do
i ndihmojë ata të
zhvillojnë të folurin dhe
aftësitë komunikuese.
**Shiko, dëgjo dhe
bisedo!**



Shiko, dëgjo dhe bisedo.

Bisedat që ti zhvillon
me fëmijën tënd mund
të ndryshojnë të
ardhmen e tyre.




E dije këtë?

Nëse i flet bebit përpara se
ai të fillojë të thotë ndonjë
fjalë, kjo e ndihmon atë të
mësojë të flasë.

Përpiqu të bisedosh me
“belbëzime” me ta duke
kopjuar tingujt që ato bëjnë!

Pse?



90% e trurit të fëmijës tënd zhvillohet deri kur ata mbushin pesë vjeç.

Ti mund ta ndihmosh këtë zhvillim duke gjetur mundësi për të folur dhe për t'i dëgjuar ata sa më shpesh që të jetë e mundur, dhe t'i prezantosh atyre gjëra të reja.

Si?

- Lexoji kartat për të marrë ide dhe merri me vete kur del.




- Lëre fëmijën të të drejtojë (vështro gjërat për të cilat janë të interesuar ato).

- Bisedat që ti zhvillon me fëmijën tënd mund të bëjnë diferencën.



Ti mund të vështrosh dhe të flasësh për...


Gjërat që jetojnë, që lëvizin, që mund t'i dëgjosh ose nuhasësh, motin, shkronjat dhe numrat, mënyrat e ndryshme si mund të lëvizësh, format, materialet dhe shumë të tjera.



Ti mundesh:

Numëro

1 2 3 4 5



Vështro gjërat
e vogla

Përdor shqisat e tua



Kërce në një pellg



Luaj Unë spiunoj



Këndo një këngë
ose ninullë



Përgatit një tregim
ose këngë




Lëviz në mënyra
të ndryshme

**Të lësh fëmijën
të të drejtojë.
Të flasësh për
gjërat që po
bëjnë dhe kanë
vënë re.**



E dije këtë?

Nëse i tregon fëmijës
tënd se je i interesuar
në atë çfarë po bëjnë
dhe thonë ata, kjo rrit
vetbesimin e tyre.



Kjo është ide e mirë!
Hedhja e hapave të
vegjël të ndihmon të
mbash ekuilibrin


Kur ti flet për atë
çfarë unë po bëj,
kjo më mëson
fjalë të reja

**Jepi bebit ose
fëmijës tënd kohë
të mendojë dhe të
përgjigjet kur ti
flet me ta.**



Këshilla kyçe:

**Prit të paktën
5-15 sekonda që fëmija
yt të përgjigjet kur
flet me ta.**



Më ndihmo nëse
më jep kohë për
t'u menduar

Kur pres deri sa
ajo të përgjigjet,
ajo më jep
përgjigje më
të mirë

**Përsërit tingujt dhe
fjalët që thotë fëmija
yt, dhe shto një ose
dy tinguj ose fjalë
të tjera.**



E dije këtë?

**Kur ti kopjon atë që thotë
fëmija yt, kjo i tregon atyre
që ti po i dëgjon ata. Shtimi
i një ose dy fjalëve i mëson
atyre fjalë të reja dhe si të
thonë fjali më të gjata.**



mace

Po, ajo mace ka bisht
me shumë gëzof

da da da, po, mace


dadadada

Jepi vëmendje kur ke kohë të lirë. Ndalo dhe tregoji fëmijës tënd se je duke e dëgjuar.



Këshilla kyçe:

Ndihmoje fëmijën tënd t'i afrohet, të vështrojë gjërat që ata mund të shohin ose dëgjojnë.



**Kur të shikoj fytyrën
ndërkohë që flas,
kjo më mëson mua
të komunikoj**


**Kur ndaloj
dhe i jap atij
vëmendjen
time të plotë,
ai duket shumë
i lumtur**

**Mendo për llojin e
pyetjeve që bën.
Pyetjet më të mira janë
ato që inkurajojnë të
menduarin, jo ato që
marrin një përgjigje me
një fjalë.**



E dije këtë?

**Nuk ka problem nëse
nuk mund t'i përgjigjesh
të gjitha pyetjeve të
fëmijës tënd.**




Jam kurioz,
ku po shkon
kermilli?

Mendoj se kermilli
po shkon...

?

**Kurdoherë që të mundesh,
përfshij të shikuarin, të
dëgjuarin dhe bashkëbisedimin
gjatë ditës.**

**Kjo do ndihmojë të folurin
dhe aftësitë komunikuese të
fëmijës tënd.**



Nëse je i shqetësuar për zhvillimin gjuhësor të fëmijës tënd, të lutem fol me një infermiere të specializuar, Family Hub ose ofrues të kujdesit ndaj fëmijës.

Ne u konsultuam me terapistë të të folurit dhe gjuhësorë, mësues, profesionistë të moshave të hershme dhe me prindër për të krijuar këto karta, për të të ndihmuar ty që të ndihmosh fëmijën tënd.



Për më shumë aktivitete dhe burime falas për të ndihmuar zhvillimin e fëmijës tënd, vizito wordsforlife.org.uk